

## Finalja e Garës më të madhe të Robotikës KML OPEN

Finalja e Garës më të madhe të Robotikës KML OPEN do të mbahet me datë 31 korrik, me fillim nga ora 10:00 në shkollën Shkolla Model "Qamil Batalli" - Prishtinë.

Finalja e Garës së Robotikës është rezultat i një pune të jashtëzakonshme të një komuniteti të gjerë krijuesish dhe entuziastësh i udhëhequr nga [KOSOVA MAKERS LEAGUE](#).

Në këtë ngjarje do të marrin pjesë qindra nxënës, dhjetëra shkolla, dhe do të kenë mundësinë të garojnë në të njëjtën kohë me njëri-tjetrin për të fituar biletën e pjesëmarrjes në Garën Regjionale të Robotikës.

Gjatë 4 viteve të zhvillimit të Garës së Robotikës KML OPEN, kanë marr pjesë:Â mbi 3500 nxënës pjesëmarrësÂ mbi 350 mentorë të përfshirëÂ mbi 1700 robotë edukativ mBot të shpërndarë për ekipet pjesëmarrëseÂ 27 komuna të përfshira në total.